REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr.Br. 868/20
Datë/Datum. 15.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.868/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković -Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE "IPKO Telekomunitacions"LLC - Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të njoftimit për kontratë të aktivitetit të prokurimi me titull: "Furnizim dhe shërbime te internetit VPN dhe ëLAN për Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr prokurimi: 242-20-1190-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti "Hasan Prishtina", më datën: 15.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.Hudhet, si e palejuar ankesa e operatorit ekonomik "IPKO Telekomunitacions"LLC - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim dhe shërbime te internetit VPN dhe ëLAN për Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr prokurimi: 242-20-1190-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti "Hasan Prishtina".

II.VËRTETOHET, njoftimi i AK-së per anulim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim dhe shërbime te internetit VPN dhe ëLAN për Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr prokurimi: 242-20-1190-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti "Hasan Prishtina".

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik "IPKO Telekomunitacions" LLC - Prishtinë hudhet si e palejuar, të njëjtit operator ekonomik i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE "IPKO Telekomunitacions"LLC - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 30.10.2020 me nr. 868/20, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim dhe shërbime te internetit VPN dhe WLAN për Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", me nr prokurimi: 242-20-1190-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti "Hasan Prishtina"., duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 2, 3, dhe 56, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës .

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 09.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sqarim Hyrës: Parashtruesi i ankesës përmes deklaratës ne ankese konteston anulimin e aktivitetit te prokurimit, përkatësisht përjashtimin e procedurave te prokurimit, ku AK, është thirrur ne vendimin 05/21, të datës 02.04.2020 për përjashtim nga fushëveprimi i Ligjit mbi Prokurimin Publik të shërbimeve tel komunikuese që ofron Telekomi i Kosovës, si shërbime me rëndësi të veçantë shtetërore, në harmoni me nenin 3.1 dhe 9.4 të Ligjit për Prokurimin Publik.

- **Përgjigje ne pretendimet ankimore (Neni 113)** - Për këtë aktivitet te prokurimit, tani me është hera e trete qe kontestohet, përkatësisht, "Telekomi i Kosovës"sha, kishte kontestuat inicimin e aktivitetit te prokurimit.
- Ne përmes raportit fillestar, kemi potencuar se neni 9, si tërësi, përfshirë edhe paragrafin 4, lidhet me planifikimin paraprak të prokurimit sipas nevojave që ka një Autoritet

Kontraktues i caktuar, por, jo përjashtimin nga procedura e prokurimit publik apo të drejtën për aplikim të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit. Për të njëjtën procedurë dispozitat e nenit 35, të LPP-s, sqaron kur një Autoritet Kontraktues mund të përdor procedurat e negociuara pa publikim paraprak të njoftimit.

Megjithatë, paneli shqyrtues kishte nxjerr vendim me datën 11.03.2020, me nr. 48/20, kishte anuluar njoftimin për kontrate, kundrejt këtij aktiviteti te prokurimit dhe përmes arsyetimit te te njëjtit vendim, ishte thirrur ne interpretim te KRPP-se, me tej potencohet se AK- Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", duhet ta anuloj procedurën e prokurimit dhe te merren për baze dispozitat e nenit 9.4, te LPP-se.

Prove: bashkangjitur me raport gjeni Vendimin me nr48/20, date: 11.03.2020.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, përkatësisht meqë paneli shqyrtues tani me ka nxjerr vendim për ketë aktivitet te prokurimit, ankesa e OE, te hidhet si e pa lejuar.

Autoriteti Kontraktues, nuk ka kthyer përgjigje lidhur me raportin e ekspertizës.

Operatori Ekonomik, me datë 10.11.2020, me të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Për: Organi Shqyrtues i Prokurimit

Nga: Arianit Duraku, Drejtor i Departamentit të Shitjes, IPKO Telecommunications LLC

Lënda: Reagim Iidhur me Raportin e Ekspertit Shqyrtues, Nr. 868/20, të datës 09.11.2020

Data: 10 nëntor 2020

Të nderuar,

Duke ju referuar Raportit të Ekspertit Shqyrtues 868/20, të datës 09.112020, fillimisht na lejoni të theksojmë se pajtohemi sa i përket mendimit të Ekspertit Shqyrtues, lidhur me nenin 9, dhe

paragrafit 4, marr për bazë se ashtu siç është theksuar, i njëjti në asnjë mënyrë nuk krijon hapësirë ligjore që të konsiderohet për përjashtim të aktivitetit në fjaië nga procedurat e prokurimit, marr për bazë se rastet e tilla janë në mënyrë të qartë të specifikuara në nenin 35, të Ligjit mbi Prokurimin Publik (këtu e tutje referuar: LPP).

Sa i përket mendimit të Ekspertit Shqyrtues, që ankesa të hidhet si e pa lejuar si rrjedhojë e vendimit që tashmë është nxjerrë nga paneli shqyrtues në këtë çështje, theksojmë se Vendimi i OSHP-së 48/20 i datës 11.03.2020 (i cili dhe është bashkangjitur raportit të ekspertit shqyrtues), i referohet aktivitetit të prokurimit me numër 242-19-9669-2-2-1, ndërsa ankesa e ushtruar nga ana e IPKO-së i referohet aktivitetit të prokurimit, me numër prokurimi 242-20-1190-2-2-1.

Pavarësisht të sipërshënuarave, ju njoftojmë se Autoriteti Kontraktues, në rastin e prokurimin në fjalë, në momentin e anulimit të aktivitetit të prokurimit përveç se është bazuar në a) Vendimin e OSHP, i cili siç ceket edhe në raportin e dorëzuar është në kundërshtim me mendimin e ekspertit, është bazuar dhe në b) vendimin e Qeverisë me numër 05/21, të datës 02.04.2020 *(vendim ky në të cilin është referuar dhe Vendimi i OSHP, me numër 266/20, i datës 12.06.2020), e* i cili tashmë është i shfuqizuar. Në këtë drejtim marr për bazë interpretimin jo të drejtë të nenit 9.4, të LPP si dhe të ndryshimit të rrethanave të tjera ligjore, me shfuqizimin e vendimit të Qeverisë në të cilën është referuar vendimi, detyrohet që të shqyrtohen të gjitha faktet dhe të vlerësohen të gjitha rrethanat e reja të krijuara, për zgjidhjen e kësaj çështje administrative në mënyrë të pavarur. Për më tepër, vendimi në fjale i Qeverisë së Republikës i cili është aplikuar edhe nga ana e OSHP-së ka ngritur reagime të shumta, duke përfshirë edhe reagimin e Odës Ekonomike e Kosovës dhe Odës Ekonomike Amerikanë në Kosovë, meqë rast Oda Ekonomike e Kosovës, ka lëshuar edhe rekomandimin me anë të së cilit ka kërkuar rishikimin e vendimit në fjalë, marr parasysh monopolin natyror që ka mundësuar i njëjti të krijohet. Në të njëjtën mënyrë është mirëpritur Vendimi edhe nga ana e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, i cili po ashtu kishte vlerësuar se vendimi i Qeverisë së Kosovës i datës 02.042020 nr. 05/21 është në kundërshtim me ekonominë e tregut dhe konkurrencës së lirë, kështu duke bërë thirrje që i njëjti të rishikohej, rekomandime këto të cilat rezultuan edhe në shfuqizim të vendimit në fjalë.

Arsyetimi i Vendimeve në fjalë të OSHP, për më tepër thekson praktikat paraprake të vendimmarrjes së OSHP, kështu duke theksuar dhe një numër të caktuar vendimesh. Praktikë kjo, e cila nuk do të duhej të vazhdonte të zbatohej marr për bazë zhvillimet e fundit lidhur me to pranë Gjykatave tona, nga të cilat kemi tri Aktgjykime, dy nga të cilat janë në instance të parë dhe një në instancë të dytë, të cilat janë në favorin e IPKO's për të njëjtat shkelje të cilat reflektohen edhe në Vendimet në fjalë të OSHP-së.

Në këtë drejtim, në dritë të të sipërshënuarave, kërkojmë që duke marr parasysh rrethanat e krijuara faktike dhe ligjore, të vlerësohen të gjitha faktet dhe të zgjidhet kjo çështje administrative në mënyrë meritore, duke mos abuzuar me pozitën e asnjë operatori, në dëm të një operatori tjetër.

Duke ju falënderuar, mbesim **me** shpresë se të lartshënuarat do të konsiderohen nga ana e juaj dhe ne dispozicionin tuaj që të ofrojmë mbështetjen tonë në zgjidhjen e kësaj çështj

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 15.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se për ketë aktivitet te prokurimit, është hera e tretë që ka pranuar ankesë, përkatësisht, "Telekomi i Kosovës"sha, kishte kontestuar inicimin e aktivitetit te prokurimit.

Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 05/21 i datës 02. 04. 2020 lejon përjashtim nga fushëveprimi i Ligjit mbi Prokurimin Publik të shërbimeve tel komunikuese që ofron Telekomi i Kosovës, si shërbime me rëndësi të veçantë shtetërore, në harmoni me nenin 3.1 dhe 9.4 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Paneli shqyrtues po ashtu merr parasysh interpretimin ligjor të KRPP-së ku thuhet se: "Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë duhet të marrë masa të arsyeshme që të sigurohet se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet publik". Rrjedhimisht, paneli shqyrtues i OSHP-së mendon se përderisa nuk ka ndryshime ligjore dhe nuk ka asnjë dispozitë ligjore të LPP-së që obligon autoritet publike që të marrin masa për të mos lejuar "shërbimin e konkurrencës" ashtu siç edhe rregullohet në direktiven 12. 1 të BE-së, atëherë autoritetet publike duhet te veprojnë me "blerje në shtëpi" ashtu siç është praktikuar deri më tani dhe është paraparë edhe në interpretime të KRPP-së si institucion gjegjes për hartim dhe monitorim të zbatimit të dispozitave ligjore.

Paneli shqyrtues vlerëson se AK ka vepruar në harmoni me dispozitat e LPP-së si dhe vendimin e fundit të Qeverisë pasiqë dihet se Telekomi i Kosovës si autoritet publik ofron shërbimet profesionale të natyrës cfarë kërkohet në këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Uni. Prishtine "Hasan Prishtina".

1x1 OE – "IPKO Telekomunitations "LLC - Prishtinë.

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.